




REPubLIKA E KOSOvËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 288/17

Nr. i fq. / Br. st - 6 -

Data: / Datum 28.09.2017

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVES

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

---

**RREGULLORE (KKV) NR.06/2017  
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TEATRIT TË QYTETIT TË  
VUSHTRRISË**

Shtator, 2017

Duke u bazuar në nenin 7, paragrafi 1 të ligjit Nr. 04/L-106 për Teatrot, dhe bazuar në nenin 21 të Statutit të Teatrit Nr. 228/14, data: 30.10.2014 të Teatrit të Qytetit, nenin 12, pika 2, shkronja (c) e ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenin 41, pika 2, shkronja (c) e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28 shtator 2017**, miratoi këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TEATRIT TË QYTETIT TË**  
**VUSHTRRISË**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të teatrit të qytetit të Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme TQV) dhe administrimin e dokumenteve të teatrit të qytetit të Vushtrrisë.

**Neni 2**  
**Fushëveprimtaria**

Teatri i qytetit të Vushtrrisë nxit zhvillimin e artit skenik, ruajtjen e identitetit kulturor, shkëmbimet teatrore, realizimin e veprave skenike të autorëve shqiptarë e të huaj, eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike, si dhe në ruajtjen, zhvillimin, dhe perfeksionimin artistik profesional të vlerave.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Teatri** - institucion kulturor publik që merret me përgatitjen, organizimin dhe realizimin e shfaqjeve teatrore dhe shfaqjeve tjera skenike.

1.2. **Shfaqja teatrore** - vepër skenike e cila shfaqet drejtpërdrejt para publikut.

1.3. **Artistë teatri** - aktorët, regjisorët, dramaturgët, skenografët, kompozitorët, kostumografët, koreografët, piktorët, valltarët, këngëtarët, muzikantët, disenjatorët e ndriçimit, disenjatorët e zërit dhe të efekteve të zërit, makiazhistët, parukierët, krijuesit, animatorët e kukullave dhe të gjithë ata që në mënyrë kreative kontribuojnë në krijimin e veprës teatrore

1.4. **Trupë teatrore** - ansambli artistik, përkatësisht grupi i artistëve që krijon shfaqje teatrore, të cilën e promovon dhe e shfaq para publikut si vepër artistike - skenike.

1.5. **Ministria** - nënkupton organin qendror të administratës shtetërore, që drejton një fushë të caktuar të veprimtarisë (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit).

1.6. **Ligji** - Ligji për Teatrot - normë, rregull që vendoset nga organi më i lartë i pushtetit shtetëror dhe është e detyrueshme për të gjithë organet shtetërore dhe për të gjithë shtetasit.

1.7. **Këshilli Artistik** - është një organ kolegjal, vendimmarrës i cili përbëhet nga 5 anëtarë, personalitete të kulturës dhe artit.

1.8 **Art-** është forma e pasqyrimit të botës nëpërmjet riprodhimit të realitetit në mënyrë krijuese me anë figurash artistike dhe veprimtaria artistike.

1.9.**DKRS** – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;

1.10.**TQV**-Teatri i Qytetit të Vushtrisë.

#### **Neni 4 Audicionet**

Audicionet për përzgjedhjen e aktorëve realizohen komform legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 5 Kriteret e vlerësimit të performancës**

1. Metoda e vlerësimit të performancës shprehet me pikë duke u renditur sipas:

- 1.1. 100 - 90
- 1.2. 89-70
- 1.3. 69-50
- 1.4. 49-30
- 1.5. 29-5

2. Rezultatet shpallen pas përzgjedhjes sipas afatit ligjor.

#### **Neni 6 Rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike**

1. Sistemet kompjuterike në pronësi të TQV-së, duhet të përdoren vetëm për këto qëllime zyrtare:

- 1.1. Përdorimi për nevoja personale i postës elektronike apo faqes zyrtare të TQV-së është i kufizuar, duke garantuar përparësinë e përdorimit për qëllime zyrtare;
- 1.2. Cilido përdorues, kur konstatohet se për një kohë të gjatë përdor këto burime për qëllime personale, i ndërpritet mundësia e përdorimit të këtyre mjeteve. Në këto raste, përgjegjësi propozon fillimin e procedurave për masë disiplinore;

- 1.3. Posta elektronike që dërgohet nga këto sisteme duhet të konsiderohet si çdolloj tjetër komunikimi. Këto mjete komunikimi në tërësinë e tyre përfaqësojnë institucionin, ndaj duhet të shkruhen sipas standardeve të gjuhës shqipe.

## **Neni 7 Komunikimi me media**

Në emër të TQV-së mund të prononcohet vetëm drejtori i përgjithshëm ose personi i autorizuar prej tij/saj.

## **Neni 8 Arkivimi i dokumentacionit artistik dhe teknik**

1. Në arkiv ruhen dokumentet origjinalë në figurë dhe në zë të krijuara gjatë veprimtarisë artistike të TQV. Ekzemplari i paprekshëm i fonodokumenteve dhe fotodokumenteve, nuk janë objekt shitblerjeje dhe janë pjesë e fondit arkivor të TQV, si dokumente me rëndësi historike kombëtare si në vijim:

- 1.1. Fonodokumentet (incizimi i parë në pllakë dhe në shirita magnetikë, videokaseta, DVD etj.) dhe ekzemplari i parë i dokumenteve në tekst që shoqërojnë apo shpjegojnë këto dokumente;
- 1.2. Fotodokumentet (fotografitë, filmat, negativat, diapozitivat etj.) në origjinal;
- 1.3. Fotografitë që paraqesin ngjarje, peizazhe, portrete;
- 1.4. Ekzemplarët e shumëfishuar që shërbejnë si kopje pune, si dubëlpozitivi i figurës;
- 1.5. dubëlnegativi i kopjes përfundimtare të pozitivit të filmit, fotografitë ose riprodhimet e tyre, riprodhimet e incizimeve në shirit magnetik ose në shirit-video, etj;
- 1.6. Dokumentet në zë ku përfshihen regjistrimet artistike dhe aktivitetet artistike;
- 1.7. Regjistrime të proceseve të punës në TQV;
- 1.8. Dokumentet në figurë dhe në zë (filmata, shiritat magnetikë dhe fotografitë) që hyjnë dhe ruhen në arkiv, regjistrohen në regjistrin themeltar të materialeve hyrëse arkivore;
- 1.9. Subjekti komunal (TQV) është i detyruar të ruajë një ekzemplar të paprekshëm të këtyre dokumenteve në arkiv;
- 1.10. Arkivi ka të hartuar skedarin informatik shkencor për të lehtësuar shfrytëzimin e dokumenteve në figurë dhe në zë, si dhe regjistrat inventare në përputhje me skemën e klasifikimit të këtyre dokumenteve;
- 1.11. Arkivi bën evidencimin ku pasqyron përmbajtjen, përpunimin tekniko-shkencor dhe siguron ruajtjen e dokumenteve në figurë dhe në zë, ku përfshihet njësisia e

- ruajtjes dhe të gjitha fotodokumentet dhe fonodokumentet që janë të hyra në të. Këtu futen dhe evidencohen edhe fotoalbume të ndryshme, etj;
- 1.12. Inventarët e fotodokumenteve janë në dy ekzemplarë, nga të cilët një në arkivin e institucionit fondkrijues (TQV) dhe një në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore (Ligji për Trashëgiminë Kulturore);
  - 1.13. Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, me vlera unike të trashëgimisë kulturore kombëtare, paraqiten jashtë shtetit me vendim të komunës.

## **Neni 9**

### **Funksionimi i Arkivit të TQV-së**

1. Arkivi funksionon si pjesë strukturore që përgjigjet për administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të TQV-së.
2. Personi përgjegjës për menaxhimin e dokumentacionit administrativ kryen këto detyra:
  - 2.1. Administron dokumentet me rëndësi historike kombëtare;
  - 2.2. Administron dokumentet me afat të ruajtjes së përkohshme;
  - 2.3. Mikrofilmat apo fotokopjet e dokumenteve të sjella nga jashtë shtetit, prej studiuesve shkencorë të subjekteve;
  - 2.4. Administron vulat e institucionit të TQV-së;
  - 2.5. Kryen veprime për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës;
  - 2.6. Bëhet përpunimi tekniko-shkencor dhe ekspertiza e vlerës të ruajtjes së dokumenteve (Kronologji-Strukturë);
  - 2.7. Organizohet puna për shfrytëzimin e dokumenteve për plotësimin e kërkesave operative nëpërmjet mjeteve të informimit.

## **Neni 10**

### **Pajisja e teatrit me bileta**

1. DKRS-ja e pajis TQV-në me bileta për shfaqje teatrale.
2. Obligohet zyrtari i TQV-së që me procesverbal pas përfundimit të shfaqjes të raportojë në DKRS.

**Neni 11**  
**Tarifat për shfaqjet teatrale**

1. Për një shfaqje teatrale premierë çmimi është 2 euro.
2. Për një shfaqje teatrale reprizë çmimi është 1 euro.
3. Përgjegjësi i teatrit bën marrëveshje të veçantë me shitësin e biletave, ku përcaktohet në detaje mënyra e menaxhimit të këtij procesi.

**Neni 12**  
**Përgjegjësit për zbatimin e kësaj rregulloreje**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet TQV-ja, ndërsa monitorimin e zbatimit të saj e bën DKRS-ja

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**

**Kryesues i Kuvendit**